



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJETLLËS KANALIZIME VLORË SH.A

Nr. _____, Prot.

Vlorë, më _____.____.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Studim Projektim për sistemin e furnizimit me ujë për fshatrat Karbunar-Resulaj-Rromës, Njësia Selenicë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

71335000-5 - Studime inxhinierike

VLERA E FONDIT LIMIT:

4,000,000 (katër milion) Lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Vlore sha** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas Shtojcës 9 të DST

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (**2023, 2024, 2025**) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros **për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar** duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2/a dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar). Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, (i ndryshuar).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për vitin **2026** (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006

“Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me një vlerë **jo më të vogël se 19% e vlerës së përlllogaritur** të objektit që prokurohet.

- a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të realizuara.
- b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të realizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Duke qenë se kjo procedure prokurimi do të konkludojë me një kontratë shërbim projektimi për të deshmuar përvojën e mëparshme vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë 3 viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë licencë projektimi sipas rregullores së miratuar me VKM nr. 943, datë 28/12/2016 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrje e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”.

Licenca e projektimit duhet të ketë kategoritë si më poshtë:

- 3.a Objekte civile - industriale - turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.
- 3.c-2 Projektim troje dhe shpate me qëndrueshmëri të ulet
- 4.c Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.
- 4.f Projektim të sistemeve kundra zjarrit.
- 4.g Projektim të sistemeve të monitorimit dhe automatizimit në industri dhe ndërtesa
- 4.j Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë... sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit, etj.
- 5.b Furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi.
- 5.c Ujësjellës- kanalizime urbane – rurale.
- 5.f Vepra hidroteknike, galeri e tunele hidraulike, marrje uji, shkarkimi- shkarkues të ujërave të tepërta, vepra të marrjes së ujit nga rezervuarët, vepra të marrjes së ujit nga lumenjtë dhe marrja e ujit me puse.
- 6.a, Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.
- 8.a Rivelime inxhinierike.
- 8.b Rilevime inxhinierike kadastrale.
- 8.d Bazamente gjeodezike
- 8.e Projektim fotogrametrik dhe hartografik
- 9.a Studim/ Vlerësim gjeologo inxhinierik i truallit për objekte civile-ekonomike deri 5 kate
- 9.c Studim/Vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulet
- 9.e Studime e projektme hidrogjeologjike
- 10.e Projektim kabina elektrike të rrjetit shpërndarës – linja të tensionit të ulët – të mesëm.
- 12.e Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për trojet e shpate me qendrueshmëri të ulet dhe për troje ndertimore të shkrifeta me mundësi lëngzimi.
(Për Operatorët e huaj të bëhet njëhësi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga MZHUT ose institucione të tjera të autorizuara sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studim projektimit në***

ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” - lidhja 4 “kushte dhe kritere specifike që kryesisht duhen plotësuar për të fituar kategoritë në fushat e studimit dhe projektimit

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

KATEGORIA	PËRSHKRIMI	ARGUMENTIMI BAZUAR NË DETYRËN E PROJEKTIMIT
3.a	Objekte civile-industriale-turistike prej murature e skelet beton-arme deri në 5 kate.	Detyra e Projektimit parashikon punime të rëndësishme strukturore dhe konstruktive në objekte civile: (i) rehabilitim i katër depove ekzistuese prej beton-armeje (Karbunarë, Selenicë, Resulaj, Roms) me "riparim i strukturës së betonit, heqje e shtresave të dëmtuara, riparim i çarjeve me beton/Ilaç riparues" (pikat 4.1.3 dhe 4.2.4); (ii) ndërtim/rehabilitim i godinave të dy stacioneve të pompimit (pikat 4.1.2 dhe 4.2.2), përfshirë riparim të mureve, çatisë, dyshemesë dhe drenazhit perimetral; (iii) ndërtim i njësisve të reja të klorifikimit në secilën depo kryesore; (iv) ndërtim i rrethimeve mbrojtëse metalike me lartësi minimale 2.0 m në secilën depo. Detyra e kërkon eksplisit në pikën 6.1 "Relacion konstruktiv për të gjitha veprat civile (depo, godina, mure mbajtës)". Të gjitha këto janë objekte civile prej murature e skeleti beton-arme me lartësi shumë nën 5 kate, që përcaktojnë kompetencën projektuese të kësaj kategorie.
3.c-2	Projektim në troje dhe shpate me qëndrueshmëri të ulet.	Detyra e Projektimit identifikon në mënyrë eksplicite "teren kodrinor me segmente të rrëshqitshme" përgjatë linjave Selenicë → Resulaj/Roms (pika 3, përshkrimi i nën-skemës), si dhe kërkon në pikën 4.2.3 që projektuesi të propozojë shtrirje të re të linjave kryesore duke ndjekur kriterin: "Shmangie maksimale e segmenteve me rrëshqitje aktive të konstatuara dhe me pjerrësi të lartë tërthore". Hartimi i veprave të artit, blloqeve shtytëse, nyjeve fleksibël në segmentet kritike dhe i mureve mbajtës në këto shpate me qëndrueshmëri të ulet kërkon kompetencë të dedikuar projektimi konstruktor, duke garantuar

		stabilitetin dhe sigurinë e veprave për horizontin 25-vjeçar të projektimit.
4.c	Projektim i linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.	Detyra e Projektimit parashikon instalime elektrike komplekse brenda objekteve, përfshirë: (i) për stacionet e pompimit — paneli i komandimit, mbrojtja motorike (termike), matësi elektromagnetik i debitit, matësi i presionit, ndriçimi i brendshëm i godinave (pikat 4.1.2 dhe 4.2.2); (ii) për të katër depot — sistemi i ndriçimit teknik me panele solare fotovoltaike (1–2 kW), akumulator, kontrollor ngarkimi dhe ndriçim LED (pikat 4.1.3, 4.2.1, 4.2.4); (iii) për njësitë e klorifikimit — instalimet e pajisjeve të dozimit proporcional dhe alarmeve. Të gjitha këto janë instalime elektrike brenda objekteve civile/industriale, që përcaktojnë kompetencën e kërkuar nga kjo kategori.
4.f	Projektim i sistemeve kundra zjarrit.	Detyra e Projektimit parashikon në pikën 4.1.5 (Rrjeti i shpërndarjes në Karbunarë) vendosjen e "Hidrantëve për qëllime zjarrfikëse (në mundësi, distancë maksimale 100 m nga objektet e mbrojtura)" si pjesë integrale të rrjetit të ri shpërndarës. E njëjta logjikë zbatohet edhe për rrjetet e Resulaj dhe Romsit. Përcaktimi i pozicionit, debitit dhe presionit të hidrantëve, llogaritja e volumit rezervë të depove për qëllime zjarrfikëse, si dhe verifikimi i përputhshmërisë me normat teknike në fuqi, kërkojnë kompetencë projektuese specifike në fushën e mbrojtjes nga zjarri.
4.g	Projektim i sistemeve të monitorimit dhe automatizimit në industri dhe ndërtesa.	Detyra e Projektimit parashikon për të dy stacionet e pompimit (pikat 4.1.2 dhe 4.2.2): "Sistem mbikëqyrjeje në distancë (SCADA) për integrim në qendrën e kontrollit të UKV-së" dhe "sistem mbikëqyrjeje në distancë (SCADA) për kontroll dhe regjistrim parametrash në qendrën e UKV-së". Po ashtu parashikon sisteme automatike: dozim proporcional i klorit në katër depo (NaOCl sipas pikës 5.2), mbrojtje motorike termike, komutim automatik gjenerator/rrjet (ATS) për gjeneratorin rezervë, monitorim i nivelit dinamik/statik të pusave (pika 4.1.1), matje automatike e debitit dhe presionit. Projektimi i arkitekturës SCADA për dy stacione pompimi dhe katër depo, i logjikës së automatizimit dhe i protokolleve të komunikimit, kërkon në mënyrë të domosdoshme kompetencën projektuese të kësaj kategorie.
4.j	Projektim i rrjeteve të telefonisë, citofonisë, internetit, sistemeve të alarmit, sistemeve të dedektimit, etj.	Detyra e Projektimit kërkon "sistem alarmi" për dy stacionet e pompimit (pikat 4.1.2 dhe 4.2.1). Po ashtu, integrimi i sistemit SCADA në qendrën e kontrollit të UKV-së sh.a. për gjashtë objekte (dy

		stacione pompimi + katër depo) presupozon rrjet komunikimi dhe transmetim të dhënash midis tyre dhe qendrës, që kërkon kompetencë projektuese në fushën e sistemeve të alarmit dhe komunikimit, sipas tekstit specifik të kësaj kategorie.
5.b	Furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi.	Vetë objekti i kontratës është furnizim me ujë i pijshëm për fshatrat Karbunarë, Resulaj dhe Roms. Po ashtu, projektimi përfshin tubacionet e shkarkimit dhe të shfryerjes nga katër depot (pikat 4.1.3, 4.2.1, 4.2.4), valvulat e shkarkimit në pikat e ulëta të linjave kryesore Pus → Depo Karbunarë (Ø 250 PN 25) dhe Selenicë → Resulaj/Roms (pika 4.2.3), si dhe valvulat e shkarkimit në rrjetet e reja shpërndarëse të të treja fshatrave. Të gjitha këto bien drejtpërsëdrejti në fushën e veprimit të kësaj kategorie.
5.c	Ujësjellës-kanalizime urbane-rurale.	Objekti i prokurimit është projektimi i një skeme të plotë ujësjellësi me dy nën-skema funksionalisht të dallueshme: (i) nën-skema Karbunarë (e izoluar, e furnizuar nga Pusi i Karbunarës në breg të Vjosës); (ii) nën-skema Selenicë–Resulaj–Roms (sistem i integruar me Depo Selenicë si nyje kryesore dhe dy degë paralele pompimi). Detyra parashikon hartimin e rrjeteve të reja shpërndarëse për Karbunarë (pika 4.1.5), Resulaj dhe Roms (pika 4.2.5), llogaritjet hidraulike për horizontin 25-vjeçar, dimensionimin e tubacioneve PEHD PN16-PN20, instalimin e valvulave seksionuese, reduktorëve të presionit dhe lidhjeve individuale me matës uji për çdo konsumator. Kjo është kategoria bërthamë e projektit.
5.f	Vepra hidroteknike, galeri e tunele hidraulike, marrje uji, shkarkimi, vepra të marrjes së ujit nga rezervuarët, nga lumenjtë dhe marrja e ujit me puse.	Teksti i kësaj kategorie përmend "marrja e ujit me puse" — që është pikërisht natyra e veprave të marrjes të këtij projekti. Detyra e Projektimit përfshin: (i) rehabilitim i Pusit të Karbunarës në breg të Vjosës me pastrim mekanik, verifikim, riparime strukturore, vendosje tubi të ri ngritjes, valvulë kthimi dhe pajisje matjeje të nivelit dinamik/statik, si dhe ngritje të nivelit të vendosjes së pompave (pika 4.1.1); (ii) shfrytëzimi i Pusit të Selenicës si burim kryesor i nën-skemës Selenicë–Resulaj–Roms; (iii) rehabilitimi i katër depove ekzistuese (vepra hidroteknike); (iv) projektimi i sistemit të transmetimit me veprat e artit përkatëse (blloqe shtytëse, valvula ajrimi/shkarkimi, nyje fleksibël). Të gjitha këto janë vepra hidroteknike që kërkojnë kompetencën e kësaj kategorie.

6.a	Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.	Trasja e tubit kryesor Ø 250 PN 25 për degën Pus → Depo Karbunarë (pika 4.1.4), shtrirjet e reja të linjave kryesore Selenicë → Resulaj dhe Selenicë → Roms (pika 4.2.3), si dhe traset e rrjeteve të reja shpërndarëse për tre fshatrat kalojnë në pjesë të konsiderueshme përgjatë rrugëve lokale dhe interurbane dytësore të Nj.A. Selenicë dhe Nj.A. Qendër Vlorë, Bashkia Vlorë. Projektimi i shtresave të restaurimit të trupit rrugor pas hapjes së kanaleve, profileve tërthore dhe hyrjeve teknike për qasje në stacionet e pompimit, pusat dhe depot, kërkon kompetencë projektuese rrugësh.
8.a	Rilevime inxhinierike.	Detyra e Projektimit, në pikën 6.1, kërkon "Rilevime topografike të zonës së projektit". Tabelat 8.1 dhe 8.2 të Detyrës listojnë pikat kryesore me koordinata gjeografike që duhen verifikuar e plotësuar në terren, përfshirë pikat "të rilevohet" për Pusin e Selenicës, Stacionin e Pompimit Selenicë, Depo Resulaj dhe Depo Roms. Po ashtu, shtrirja e re e linjave Selenicë → Resulaj/Roms e parashikuar në pikën 4.2.3 kërkon rilevime të reja topografike detaje. Rilevimi inxhinierik është kërkesë eksplicite dhe e padiskutueshme e Detyrës.
8.b	Rilevime inxhinierike kadastrale.	Detyra e Projektimit, në pikën 4.2.3 (Linjat kryesore Selenicë → Resulaj dhe Selenicë → Roms – zëvendësim i plotë me shtrirje të re), : "Shmangie e pronave private aty ku është e mundur, ose koordinim për servitudet e nevojshme". Kjo kërkesë presupozon rilevime kadastrale për identifikimin e kufijve të parcelave që preken nga shtrirja e re e linjave, përgatitjen e dokumentacionit për servitudet, si dhe konfirmimin e statusit pronësor të truallit ku ndodhen katër depot ekzistuese dhe dy stacionet e pompimit.
8.d	Bazamente gjeodezike.	Gjatësia totale e trasesë së projektit (linja kryesore Pus → Depo Karbunarë, linja Selenicë → Resulaj me shtrirje të re, linja Selenicë → Roms me shtrirje të re, dhe tri rrjete të reja shpërndarëse) është e konsiderueshme dhe kalon në terren kodrinor me ndryshime kuotash të theksuara. Saktësia e rilevimeve topografike në këto gjatësi dhe relief, sidomos në segmentet me rrëshqitje aktive ku është kërkuar shtrirje e re, kërkon vendosjen e një rrjeti bazamentesh gjeodezike kontrolli si pika referimi për piketimin e saktë të gjurmës së linjave dhe objekteve të sistemit.
8.e	Projektim fotogrametrik dhe hartografik.	Detyra e Projektimit përmend (figura 1 dhe figura 2) "pamje satelitore, Google Earth". Po ashtu, sipas pikës 2.3.7 të DST, kërkohet "Dron Profesional" si

		<p>pajisje e nevojshme për ofrimin e shërbimit. Përdorimi i UAV-së për fotogrametri ajrore është teknikisht i justifikuar dhe i domosdoshëm për dy arsye specifike të këtij projekti: (i) dokumentimi i detajuar i zonave me rrëshqitje aktive përgjatë linjave Selenicë → Resulaj/Romsi për të mundësuar përzgjedhjen optimale të shtrirjes së re; (ii) prodhimi i ortofotove dhe modeleve dixhitale të lartësisë (DEM/DTM) për profilet gjatësore të linjave të reja të transmetimit. Po ashtu, kërkesa e pikës 6.2 për planimetri 1:5000–1:10000, 1:1000–1:2000 dhe 1:500–1:1000 është prodhim hartografik që kërkon kompetencën e kësaj kategorie.</p>
9.a	Studim/Vlerësim gjeologjiko-inxhinierik i truallit për objekte civile-ekonomike deri 5 kate.	<p>Detyra e Projektimit, në pikën 6.1, kërkon "Studim gjeoteknik dhe hidrogjeologjik (përfshirë rezultatet e sondazheve për shtrirjet e reja)". Studimi gjeologjiko-inxhinierik është i nevojshëm për përcaktimin e karakteristikave fiziko-mekanike të dheut për: (i) themelimet e godinave të dy stacioneve të pompimit (ndërtim ose rehabilitim sipas pikave 4.1.2 dhe 4.2.2); (ii) mureve mbajtës që mund të kërkohen për stabilizimin e shtrirjeve të reja; (iii) themelimet e dhomave të reja të klorifikimit në katër depot.</p>
9.c	Studim/Vlerësim gjeologjiko-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.	<p>Detyra e Projektimit identifikon "rrëshqitje aktive të konstatuara" dhe "pjerrësi të lartë tërthore" përgjatë linjave Selenicë → Resulaj/Romsi (pika 4.2.3), duke kërkuar "Studim gjeoteknik paraprak për konfirmimin e qëndrueshmërisë së trasesë së propozuar". Kjo kategori plotëson kategorinë 9.a (që mbulon objekte deri 5 kate në troje të zakonshme) për pjesën specifike të shpateve me qëndrueshmëri të ulët ku kalon shtrirja e re e linjave, si dhe për vlerësimin e zonave të rrëshqitjeve aktive që duhen shmangur ose stabilizuar.</p>
9.e	Studime e projekte hidrogjeologjike.	<p>Projekti është i centruar mbi dy puse uji të pijshëm — Pusi i Karbunarës (në breg të Vjosës) dhe Pusi i Selenicës. Studimi hidrogjeologjik është i domosdoshëm dhe me peshë qendrore për: (i) karakterizimin e shtresave ujëmbajtëse dhe vlerësimin e qëndrueshmërisë së prurjes së pusave për horizontin 25-vjeçar; (ii) përcaktimin e nivelit dinamik dhe statik për dimensionimin e saktë të pajisjeve të pompimit (pika 4.1.1 e Detyrës e kërkon pajisjen e matjes së nivelit dinamik/statik dhe ngritjen e nivelit të vendosjes së pompave); (iii) analizat laboratorike kimike dhe mikrobiologjike të ujit në burim sipas VKM Nr. 379/2016 (pika 4.1.1); (iv) përcaktimin e zonave të mbrojtjes higjieno-sanitare. Po ashtu, ndodhja e Pusit të Karbunarës në</p>

		breg të lumit Vjosa kërkon vlerësim të ndërveprimit hidrogeologjik lum-pus.
10.e	Kabina elektrike të rrjetit shpërndarës – linja të tensionit të ulët – të mesëm.	Detyra e Projektimit e kërkon në pikën 4.1.2: "Lidhje me rrjet elektrik dhe parashikim i grupit elektrogjenik (gjenerator) rezervë për emergjenca". Projekti përfshin dy stacione pompimi me ngarkesë elektrike të konsiderueshme: (i) stacioni i Karbunarës me grup pompues 1+1 rezervë (pika 4.1.2); (ii) stacioni i Selenicës me dy grupe pompuese paralele me rezervë 1+1 secili — gjithsej katër pompa elektrike (pika 4.2.2). Realizimi i lidhjes me rrjetin OSHEE kërkon projektimin e: kabinës së matjes në pikën e lidhjes me operatorin e shpërndarjes, kabinës TM/TU nëse fuqia e instaluar e kërkon, linjave të tensionit të ulët midis pikës së lidhjes dhe panelit kryesor të secilit stacion, si dhe sistemit të komutimit automatik gjenerator/rrjet (ATS) për funksionim emergjent. Kjo kategori plotëson kategorinë 4.c (që mbulon instalimet elektrike brenda objekteve) për pjesën specifike të infrastrukturës që ndërvepron me rrjetin shpërndarës publik.
12.e	Studime/Vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për trojet e shpate me qëndrueshmëri të ulet dhe për troje ndërtimore të shkrifëta me mundësi lëngëzimi.	Detyra e Projektimit identifikon "rreshqitje aktive të konstatuara" dhe "pjerrësi të lartë tërthore" përgjatë shtrirjeve të reja të linjave Selenicë → Resulaj/Romsi (pika 4.2.3). Vlerësimi sizmologjik inxhinierik i këtyre trojeve është i domosdoshëm për: (i) konfirmimin e qëndrueshmërisë sizmike të shtrirjes së re të linjave; (ii) dimensionimin sizmik të mureve mbajtëse dhe veprave të artit në segmentet kritike; (iii) shmangien e fenomeneve të lëngëzimit dhe rreshqitjeve gjatë veprimit sizmik për horizontin 25-vjeçar të projektimit. Po ashtu, ndodhja e Pusit të Karbunarës në breg të lumit Vjosa në troje të shkrifëta aluviale kërkon vlerësim të mundësisë së lëngëzimit gjatë ngjarjeve sizmike.

2.3.3 Një punësim mesatar i të paktën **10 (dhjete) personave**, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- b. Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar.

Shënim: Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.

Argumentimi: Këto kërkesa për stafin janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma ”c” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punetore është bërë në përputhje me realizimin e suksesshëm të shërbimit për objektin.

2.3.4 Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të përfshirë në licencën e shoqërisë si drejtues teknik, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV, diplomë dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (nje) Inxhinier Gjeodet/Markshajder/Topograf.
- 1 (nje) Inxhinier Gjeolog
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik

Drejtuesit teknik si më sipër duhet të jenë të punësuar pranë shoqërisë dhe të përmbushin kriteret sipas parashikimeve të vendimit nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”.

Shënim: Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Spas Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar Neni 77 Kërkesat për kualifikim, pika 4 Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Stafi i mesiperm, do të realizojë projektet sipas kompetencës dhe licencës bazuar në VKM nr.759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

2.3.5 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë staf mbështetës për realizimin e këtij shërbimi punonjësit e mëposhtëm vërtetuar me a) kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, librezë

pune dhe të listuar në listpagesat e Shoqërisë për periudhën 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës:

Staf Ndhmës si më poshtë,

- **1 (një)** punonjës me certifikatë "**Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë**" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10237 datë 18/02/2010 "Përsigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr.312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Përsigurinë në kantier", shoqëruar me kontratën individuale të punës të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe te figuroje ne listpagesat e shoqerise per 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.(Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomike,grupimi duhet te kete pjese te stafit te tij 1 nje punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë")
- **1 (një)** punonjës i pajisur me certifikate "**Ekspert për ndihmën e pare dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave**" e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqeri te akredituara ose nga ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, Per kete duhet te paraqitet certifikata e tranimit si ekspert per dhenien e ndihmes se pare dhe nderhyrjes ndaj emergjencave" e dhene nga nje organizem i licencuar,shqiptar ose i huaj, kontrata e punes, si dhe te figuroje ne listpagesat e shoqerise per 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. (Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomike,grupimi duhet te kete pjese te stafit te tij 1 nje punonjës " Ekspert për ndihmën e pare dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave")
- **1 (një)** punonjës specialist "**Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpetimin**" nëpërputhje me klauzolat Ligjit Nr. 152/2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin",Neni 49, pika 4, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certificate dhene nga Drejtoria MZSH, si dhe te figuroje ne listpagesat e shoqerise minimumi per 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. (Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomike,grupimi duhet te kete pjese te stafit te tij 1 nje punonjës "Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpetimin")
- **1 (një)** punonjës me certifikatë "**Ekspert për ndikimin e vlerësimit në mjedis**" (VNM) të pajisur me certifikatë të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/certifikatë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit, të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, Grupimi duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) specialist "Ekspert për ndikimin e vlerësimit në mjedis").

Shënim: Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë një liste personeli kryesor të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose

komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Njesia e prokurimit per vendosjen e stafit ndihmës i eshte referuar Termave References .

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a) Certifikatën e cilësisë së punimeve **ISO 9001-2015** (e vlefshme)/ose/ekuivalent **Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë**.
- b) Certifikatën e cilësisë së punimeve **ISO 14001-2015** (e vlefshme)/ose/ekuivalent **Për sistemin e menaxhimit cilesise se Mjedisit**.
- c) Certifikatën e cilësisë së punimeve **ISO 45001-2018** (e vlefshme)/ose/ekuivalent **Për sistemin e Menaxhimit të Shendetit dhe Sigurise ne Pune**.
- d) Certifikatën e cilësisë së punimeve **ISO 50001:2018** (e vlefshme)/ose/ekuivalent **Për sistemin e Menaxhimit të Energjise**.

Shënim: Në rastet e Bashkimit te Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqese certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizoje sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.6 gërma “a”- “c” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, qe i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me **ISO 9001:2015** me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me **ISO 14001:2015** me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ushtrorjnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001:2018 është standard ndërkombëtare, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me **ISO 45001:2018** me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

ISO ISO 50001:2018 është standard ndërkombëtare, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e energjise. AK gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me **ISO 50001:2018** me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e menaxhimit të energjise në godinat e impiantit për të bërë ato sa më eficiente dhe duke marrë masa në tërësi për të ulur kostot e harxhimit të energjise.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve që do shërbejnë për ofrimin e shërbimit të projektimit, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme:

- 1 (një) Pajisje GPS
- 1 (një) Total station
- 1 (një) Dron Profesional

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet dokumentacioni i vlefshëm, si më poshtë: dokumentacion për pajisjen në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit si pas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, për para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë pajisje, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Pajisjet e kërkuara janë vendosur në proporcion me realizimin e shërbimit.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një CV të shoqërisë për punët e realizuara gjatë aktivitetit të saj.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë eksperiencë të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit,

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose të kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Operatori ekonomik ofertues në përllogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet të jetë brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të VKM nr 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim" i azhurnuar.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim

Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike dhe termat e references janë hartuar nga specialist i fushës, i cili ka njohuri të posacme për objektin e prokurimit, i cili është ngritur me urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve të teknike në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

*Specifikimet teknike dhe termat e references, për shërbimet objekt prokurimi, shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha shërbimeve dhe standardeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të shërbimit, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

Specifikimet teknike dhe fondi limit i kontratës janë hartuar prej Autoritetit Kontraktor për nevojat e së cilës po kryhet kjo procedurë prokurimi.

Detyra e Projektimit, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT.

Dokumentet e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anëtarët e njësisë kanë akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP(www.app.gov.al).

Njësia e Prokurimit
